

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Beqir Kalludra – kryetar i trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit Berat Mehmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.T, nga P rr.’I B’ pn.,për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit, PP/I.nr.72/14 të dt.24.03.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.06.12.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj dhe i akuzuari, me dt.06.12.2016 mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari D.T, i biri i E dhe F, e gjinisë Z, i lindur me dt.*data e lindjes*, në P, ku edhe jeton, rr.’I B’, p.n, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes të donët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Që nga koha e pavërtetuar e deri me dt.09.01.2014, rreth orës 22,10 min., pa lejen e organit kompetent ka mbajtur një armë të tipit ‘Pietro bereta’ kal.7.65 mm.,me nr.serik L13810, e cila është gjetur në automjetin e tij VW 1K me targa të regjistrimit ...-...-..., ku ishin duke ngrënë bukë me shokët e vet në veturë.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41,46, 69, 73, 74 dhe 374 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 359, 365, 368 dhe 450 dhe 453 të KPPRK-së, e:

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t’a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalojë 6 muaj.

Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 20 (njëzetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 69 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet arma e tipit ‘Pietro bereta’ kal.7.65 mm.,me nr.serik L13810, mjet ky me të cilin është kryer veprat penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.72/14 të dt.24.03.2016, kundër të akuzuarit D.T, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.06.12.2016, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën është akuzuar.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të kryerjes së veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit D.T, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe t'ia shqiptoj një sanksion penal përkatës, dhe me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që t'a marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe t'a vlerësoi si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari D.T i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të çfarëdo lloj sanksioni penal, si rrethanë lehtësuese ta vlerësoi pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes dhe pendimin e thellë për këtë veprim, premtimin se në të ardhmen nuk do ti përsërit veprime të tilla të ngjashme, andaj e ka lut gjykatën që mundësisht t'ia shqiptoj një sanksion sa më të butë të mundshëm penal.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, si dhe gjendjen ekonomike, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të

ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e revoles dhe mjeteve tjera me të cilat është kryer kjo vepër penale, është marrë konform nenit 69 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.162/16, dt.06.12.2016

Procesmbajtësi
 Berat Mehmeti

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
 Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
 Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
 nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.